



Politika e Konfidencialitetit Statistikor

Udhëzim për Prodhuesit e Statistikave Zyrtare në Republikën e Shqipërisë

Përmbajtja

1. Hyrje.....	2
2. Përkufizime.....	2
3. Të përgjithshme	3
4. Korniza ligjore dhe parimet statistikore ndërkombëtare	4
4.1 Ligji Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”	4
4.2 Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	7
5. Parimet statistikore ndërkombëtare	8
Shtojca 1: Deklaratë konfidencialiteti për punonjësit e Sistemit Kombëtar Statistikor	11
Shtojca 2: Deklaratë konfidencialiteti për kërkuesit shkencor	12

Alma Kondi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

1. Hyrje

Një nga parimet më të rëndësishme të institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare është ruajtja e konfidencialitetit të informacionit individual të mbledhur për qëllime statistikore. Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, në nenin 4 shkronja (d) parashikon që “Konfidencialiteti statistikor” është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt ose indirekt për qëllime statistikore nga burime administrative ose të tjera. Ai nënkupton parandalimin e përdorimit për qëllime jo-statistikore të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm të tyre”. Ky parim statistikor, i cili është në frymën e atij evropian të konfidencialitetit statistikor, parashikohet ligjërisht me qëllim që të detyrojë institucionet prodhuese të statistikave zyrtare të jenë organe të besueshme për publikun dhe veçanërisht për furnizuesit e të dhënave.

Nevojat në rritje për të dhëna (të grupuara apo mikrodata), rrisin riskun e zbulimit të informacionit individual. Për këtë arsye prodhuesit e statistikave zyrtare duhet të jenë në dijeni të këtyre risqeve dhe të implementojnë metoda për të mbrojtur privatësinë e të dhënave të mbledhura, duke siguruar ofruesit e të dhënave që informacioni identifikues ruhet i sigurtë.

Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare përpiqen të përmbushin sa më shumë që të jetë e mundur nevojat e përdoruesve të statistikave zyrtare, duke zbatuar rreptësisht kufizimet ligjore në lidhje me privatësinë e të dhënave të mbledhura, parimet statistikore dhe rregulloret përkatëse për mbrojtjen e konfidencialitetit të tyre.

Ky dokument lëshohet në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 20 (b) të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” për t’i udhëzuar anëtarëve të Sistemit Kombëtar Statistikor të vendosin standardet dhe të marrin masat e duhura për të mbrojtur konfidencialitetin e të dhënave të mbledhura dhe administruara për qëllime statistikore. Udhëzimi përmban kornizën ligjore, parimet dhe një përmbledhje të thjeshtë të metodave që përdoren për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave.

2. Përkufizime

Të dhëna konfidenciale janë të dhëna që lejojnë identifikimin e një njësie statistikore në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke zbuluar kështu informacion personal.

Zbulim informacioni ndodh kur një person apo një ndërmarrje mëson diçka që nuk dinte më parë për një person apo ndërmarrje tjetër nëpërmjet të dhënave të publikuara.

Mikrodata është forma parësore e ruajtjes së të dhënave, që përpunohet për të prodhuar rezultatet statistikore.

Identifikim i drejtpërdrejtë është identifikimi i një njësie statistikore nëpërmjet emrit, adresës ose nga ndonjë numër identifikimi që aksesohet publikisht.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Identifikim i tërthortë është identifikimi i një njësie statistikore nëpërmjet mënyrave të tjera të ndryshme nga identifikimi i drejtpërdrejtë.

Njësi statistikore është njësia bazë e vrojtimit, si p.sh. një person, një njësi ekonomike familjare, një operator ekonomik, etj.

3. Të përgjithshme

Në kuadër të misionit të tij për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e statistikave zyrtare, INSTAT mbron konfidencialitetin e të dhënave që japin njësitë raportuese (ndërmarrje, familje, etj.), për të prodhuar statistika.

Në mënyrë që INSTAT dhe strukturat përgjegjëse për prodhimin e statistikave zyrtare në institucionet e tjera publike të jenë të besuara, konfidencialiteti i të dhënave duhet të mbrohet në të gjitha hapat e prodhimit statistikor, duke përfshirë të gjithë personelin e përfshirë në përpunimin e të dhënave, nga anketuesit deri tek specialistët të cilët punojnë drejtpërdrejtë me të dhënat e mbledhura. Për këtë qëllim, ky Udhëzim përmban, në Shtojcën 1 të tij, një deklaratë konfidencialiteti tip e cila duhet të nënshkruhet nga të gjithë punonjësit e përfshirë në proceset e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të mbledhura. Gjithashtu, Udhëzimi përmban edhe një deklaratë tip e cila duhet të nënshkruhet nga kërkuesit shkencorë që kërkojnë akses në mikrodata , për të siguruar që të mos përdorin apo zbulojnë elemente të identifikimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të njësive statistikore.

Për të garantuar respektimin e konfidencialitetit statistikor dhe mbrojtjes së të dhënave, prodhuesit e statistikave zyrtare duhet të zbatojnë legjislacionin e statistikave zyrtare dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale. Përveç kufizimeve të legjislacionit kombëtar, INSTAT dhe prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare duhet të udhëhiqen nga parimet ndërkombëtare të statistikave të parashikuara në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice (CoP)) dhe parimet themelore të statistikave zyrtare të Kombeve të Bashkuara (United Nations Fundamental Principles of Official Statistics).

Në momentin e nxjerrjes së këtij Udhëzimi, INSTAT ka krijuar infrastrukturën e duhur për të siguruar mbrojtjen e konfidencialitetit statistikor nëpërmjet miratimit të disa dokumenteve konkrete, si “Politika e Shpërndarjes së statistikave zyrtare”, “Deklarata e Cilësisë”, “Rregullorja për Aksesin në Mikrodata”. Gjithashtu, INSTAT ka ngritur dy struktura të brendshme në lidhje me mbrojtjen e konfidencialitetit: Komitetin e Konfidencialitetit dhe Grupin Teknik për Konfidencialitetin.

Qëllimi i ngritjes së Komitetit të Konfidencialitetit është garantimi i parimit të konfidencialitetit statistikor nëpërmjet marrjes së masave parandaluese për sigurimin e konfidencialitetit statistikor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

gjatë proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave zyrtare, si dhe ndalimin e përdorimit të të dhënave për qëllime jostatistikore.

Grupi Teknik për Konfidençialitetin ka si qëllimin përgatitjen e udhëzimeve/rregulloreve të brendshme për stafin e INSTAT për të siguruar mbrojtjen e konfidençialitetit në përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave, në mënyrë që të parandalohet përdorimi i të dhënave për qëllime jostatistikore apo zbulimi i paligjshëm i tyre. Të përgatisë/përditësojë propozimet për draft Politikën e Konfidençialitetit të INSTAT si dhe të marrë në shqyrtim të dhënat e përpunuara nga kërkuesit shkencorë.

4. Korniza ligjore dhe parimet statistikore ndërkombëtare

Prodhuesit e Statistikave Zyrtare, si pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin specifik, ndërkohë që proceset e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave zyrtare kryhen në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare dhe mbrojtjen e të dhënave personale, sipas referencave në vijim:

4.1 Ligji Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”

Së pari, në nenin 2 të tij, ligji përkufizon kuptimin e termave “statistika zyrtare”, “Prodhues të statistikave zyrtare”, “Sistem Kombëtar Statistikor”, “Njësi statistikore” dhe “Të dhëna konfidenciale”

Neni 2

Përkufizime dhe shkurtime

1. Në këtë ligj termet e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- b) “Statistika zyrtare” është informacioni sasior dhe përfaqësues për situatën ekonomike, sociale dhe mjedisore në Shqipëri, i prodhuar nga INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, në kuadër të programit të statistikave zyrtare.
- c) “Prodhues të statistikave zyrtare” janë INSTAT-i, Banka e Shqipërisë dhe autoritetet e tjera publike, të autorizuar të prodhojnë dhe të publikojnë statistika zyrtare, sipas programit të statistikave zyrtare lidhur me fushat e përcaktuara në shtojcën 1 të këtij ligji.
- ç) “Sistemi Kombëtar Statistikor” përbëhet nga prodhuesit e statistikave zyrtare që ushtrojnë aktivitet brenda Republikës së Shqipërisë, të cilët mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika zyrtare, sipas programit të statistikave zyrtare.
-
- ë) “Njësi statistikore” është institucioni ose personi fizik a juridik ose familja apo njësia ekonomike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

që, sipas këtij ligji, është i detyruar të japë të dhëna për prodhuesit e statistikave zyrtare të autorizuar, sipas programit të statistikave zyrtare.

....

i) “Të dhëna konfidenciale” janë të dhënat, të cilat lejojnë identifikimin e drejtpërdrejt apo të tërthortë të njësive statistikore, duke zbuluar kështu të dhëna individuale.

Në nenin 4 parashikohen të gjitha parimet e statistikave zyrtare, ku përfshihet edhe ai i “Konfidencialitetit statistikor”

Neni 4

Parimet e statistikave zyrtare

.....

d) “Konfidencialiteti statistikor” është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt ose indirekt për qëllime statistikore nga burime administrative ose të tjera. Ai nënkupton parandalimin e përdorimit për qëllime jostatistikore të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm të tyre.

Konfidencialiteti statistikor rregullohet më hollësisht në nenin 31 të ligjit:

Neni 31 Konfidencialiteti

1. Të dhënat e shpërndara nga burimet e disponueshme publikisht nuk do të vlerësohen konfidenciale. 2. Të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura për prodhimin e statistikave zyrtare trajtohen si konfidenciale nga INSTAT-i, agjencitë statistikore dhe çdo organizatë ose person i caktuar prej tyre, kur këto të dhëna bëjnë që njësitë statistikore të identifikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke zbuluar të dhëna individuale, që nuk janë bërë publike për arsye të tjera. Të gjithë punonjësit e organeve/kontrolluesve, të përmendur në paragrafin e parë të kësaj pike, të cilët vihen në dijeni me të dhënat që përpunojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

3. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshme.

4. Identifikim i tërthortë do të thotë identifikimi i një njësie statistikore nëpërmjet çfarëdolloj mjeti tjetër, përveç atij të identifikimit të drejtpërdrejtë. Për të përcaktuar nëse një njësi statistikore është tërthorazi e identifikueshme, do të merren parasysh të gjitha masat e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

arsyeshme për identifikimin e njësisë statistikore në fjalë. Për mbrojtjen e identifikimit përfshihen në total të paktën tri njësi dhe pjesa e një njësie nuk duhet të kalojë 85 për qind të totalit.

5. Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura nga njësia statistikore për prodhimin e statistikave zyrtare përdoren vetëm për qëllime statistikore. Këto të dhëna botohen vetëm bashkërisht dhe nuk përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, duke përfshirë këtu vendime për kontrollin fiskal ose hetime juridike.

6. E drejta e hyrjes në të dhënat konfidenciale kufizohet për personat, të cilët, gjatë kryerjes së detyrave, kontribuojnë në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare. E drejta e hyrjes shtrihet në masën që për këto të dhëna është e nevojshme për prodhimin e statistikave në fjalë. E drejta e hyrjes për qëllime kërkimore-shkencore kufizohet në përputhje me pikën 7 të këtij neni.

7. E drejta e hyrjes në të dhënat konfidenciale për projekte kërkimore-shkencore mund të jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it për një periudhë të kufizuar, duke siguruar se të dhënat nuk lejojnë identifikimin e drejtpërdrejtë. Marrësi duhet të nënshkruajë një kontratë me INSTAT-in, sipas së cilës: a) përcaktohet qëllimi legjitim i përpunimit të të dhënave vetëm në përputhje me fushën e projektit kërkimor-shkencor; b) sigurohet se rezultati i parashikuar nuk u referohet njësive të identifikueshme ose nuk lejon identifikimin e tërthortë; c) sigurohet standardi i mbrojtjes së të dhënave konfidenciale, brenda projektit të kërkimit; 16 ç) ka një detyrim të zhdrukë menjëherë të dhënat, sapo projekti përfundon, duke njoftuar me shkrim INSTAT-in për këtë veprim.

8. Statistikat zyrtare nuk mund t'u jepen përdoruesve, duke zbuluar të dhëna konfidenciale.

9. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore marrin të gjitha masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurimit për mbrojtjen nga çdo hyrje, zbulim ose përdorim i paligjshëm i të dhënave konfidenciale.

Përveç rregullave për mbrojtjen e konfidencialitetit, neni 38 i ligjit trajton penalitetet në rast shkelje të konfidencialitetit statistikor:

Neni 38 Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

1. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë shkeljet e mëposhtme:

b) moszbatimi ose shkelja e kërkesave të konfidencialitetit, e përcaktuar në nenin 31, nga nëpunësi, përfshirë këtu dhe kohën kur ai ka lënë detyrën, ose nga një palë e tretë, së cilës i është dhënë e drejta për qëllime kërkimore, dënohet me gjobë nga 200 000 lekë deri në 300 000 lekë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

4.2 Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Të dhënat e mbledhura të cilat identifikojnë njësinë statistikore mund të jenë edhe të dhëna personale, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9888, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". . Neni 10 i këtij ligji përcakton se të dhënat personale mund të përdoren për qëllime statistikore, por duke ngarkuar subjektet përpunuese të ruajnë konfidencialitetin e tyre. Në rast shkelje, në nenin 39 të ligjit parashikohen penaltitetet përkatëse.

Kreu III

Neni 10

Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore

1. Të dhënat personale, të mbledhura për çfarëdolloj qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ.
2. Transmetimi i të dhënave sensitive për kërkimet shkencore bëhet vetëm kur ekziston një interes i rëndësishëm publik. Të dhënat personale përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin.
3. Në rastet kur përdorimi i të dhënave bëhet në një formë, që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshme. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin.

Neni 28

Konfidencialiteti i të dhënave

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 39

Kundërvajtjet administrative

1. Rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:
 - a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 50 000 lekë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

5. Parimet statistikore ndërkombëtare

Ruajtja në mënyrë diskrete e informacionit të mbledhur nuk përcaktohet vetëm me ligj, por edhe nga parimet statistikore të cilat INSTAT është i përkushtuar ti respektojë.

5.1 Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane

Dokumenti i parë që përshkruan standardet e statistikave zyrtare në Statistikat Evropiane është European Statistics Code of Practice (CoP) :

Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane përcakton standardin për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane. Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane përcakton 16 parime kryesore për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare dhe mjedisin institucional nën të cilin veprojnë autoritetet statistikore. Parimi 5 ka të bëjë me konfidencialitetin statistikor dhe citohet si më poshtë.

Parimi 5: Konfidencialiteti Statistikor dhe Mbrojtja e të Dhënave
Privatësia e ofruesve të të dhënave, konfidencialiteti i informacionit që ata ofrojnë, përdorimi i tij vetëm për qëllime statistikore dhe siguria e të dhënave janë absolutisht të garantuara.

Treguesit që masin nëse ky parim zbatohet në një Institut Kombëtar Statistikash dhe mënyra sesi INSTAT përpiqet ti përmbushë, janë paraqitur më poshtë.

5.1 Konfidencialiteti statistikor është i garantuar në ligj.

Siç u përmend më herët, në INSTAT konfidencialiteti statistikor rregullohet në nenin 31 në Ligjin për Statistikat Zyrtare.

5.2 Staf i nënshkruan deklaratë ligjore për konfidencialitetin.

Të gjithë punonjësit e INSTAT, përfshirë praktikantët nënshkruajnë një deklaratë për mbrojtjen e konfidencialitetit para ose pas fillimit të marrëdhënieve të punës. Kështu ata nënshtrohen që të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe zbulimi i informacionit konfidencial ka pasoja ligjore në formë gjobash.

5.3 Dënimet përcaktohen për çdo shkelje të qëllimshme të konfidencialitetit statistikor.

Çdo shkelje e detyrës së konfidencialitetit përbën kundravajtje sipas Ligjit Për Statistikat Zyrtare dhe dënohet me gjoba.

5.4 Stafit i vihen në dispozicion udhëzimet dhe instruksionet për mbrojtjen e konfidencialitetit statistikor në gjithë proceset statistikore. Politika e konfidencialitetit duhet të publikohet për publikun.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Politika e Konfidencialitetit duhet të publikohet në website e INSTAT dhe udhëzimet dhe instruksionet në fjalë po zhvillohen për stafin.

5.5 Masat e nevojshme administrative, teknike dhe organizative janë krijuar për të mbrojtur sigurinë dhe integritetin e të dhënave statistikore dhe transmetimin e tyre, në përputhje me praktikat më të mira, standardet ndërkombëtare, si dhe legjislacionin evropian dhe kombëtar.

Politikat e TI dhe udhëzimet dhe instruksionet e tjera të lidhura me sigurinë e informacionit në INSTAT rregullojnë proceset organizative për sigurinë e të dhënave.

5.6 Protokolle strikte zbatohen për përdoruesit e jashtëm që kërkojnë akses në mikrodata.

Akresi në mikrodata rregullohet me Ligjin për Statistikat Zyrtare si dhe në rregulloren që INSTAT ka publikuar për Aksesin në Mikrodata ku përshkruhet procedura e aplikimit dhe infrastruktura për aksesin për qëllime kërkimesh shkencore.

5.2 Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara

INSTAT gjithashtu përpiqet të përmbushë principet e UNECE Fundamental Principles of Official Statistics, ku një nga parimet kryesore është ai i Konfidencialitetit si më poshtë:

Parimi 6: Konfidencialiteti

Të dhënat individuale të mbledhura nga agjensitë statistikore për prodhimin e statistikave zyrtare, pavarësisht nëse ato i referohen personave fizikë ose juridikë, duhet të jenë rreptësisht konfidenciale dhe përdoren ekskluzivisht vetëm për qëllime statistikore.

6. Mbrojtja e konfidencialitetit në praktikë

Me qëllim të kuptueshmërisë së dokumentit, në vijim paraqitet informacioni se si zbatohet parimi i konfidencialitetit statistikor në praktikë.

INSTAT mbledh informacione përmes anketave statistikore dhe burimeve administrative të siguruara nga palët e treta për përdorim statistikor. Përveç të dhënave tabelare, rezultati i këtyre burimeve mund të jetë gjithashtu mikrodata. Në të dy rastet, konfidencialiteti duhet të mbrohet dhe INSTAT merr masa administrative dhe teknike për të siguruar mbrojtje logjike dhe fizike të informacionit privat.

Më konkretisht për të mbrojtur të dhënat sensitive përdoren disa nga rregullat kryesore që përdoren janë si më poshtë:

- Për tabelat që vijnë si rezultat i anketave/burimeve administrative, në një qelizë duhet të përfshihen në total të paktën tri njësi dhe pjesa e një njësie nuk duhet të kalojë 85% të totalit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Përsa i përket mikrodatave nga anketat, INSTAT aktualisht ka dy lloje mikrodatash:
 - Public Use Files (PUF) që janë të publikuara në website-in e INSTAT. Për mbrojtjen e konfidencialitetit këtu përgjithësisht hiqen disa variabla ku hiqen variablat si identifikues direkt apo indirekt, variablat e përdorur për kontrolle të brendshme, variabla të pa validuar, variablat e përdorur për imputimin, variabla që konsiderohen të padobishëm sepse kanë shumë vlera që mungojnë, etj.
 - Scientific User Files (SUF) mbrohen gjithashtu duke hequr emrat, variablat për adresat, duke zvogëluar detajimin e klasifikimive të përdorura (sidomos ato gjeografike) si dhe duke fshirë variabla ku ekziston rrisku i zbulimit të informacionit sensitiv.
- Përsa i përket mikrodatave nga burimet administrative, kërkuesit shkencor i jepet vetëm një kampion i caktuar, në masën 3% dhe mund të jetë subjekt i kushteve shtesë të kontratës të përcaktuar nga INSTAT.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Shtojca 1: Deklaratë konfidencialiteti për punonjësit e Sistemit Kombëtar Statistikor

Objekti

Kjo deklaratë i drejtohet Prodhuesit të Statistikave Zyrtare _____ (këtej e tutje "Institucioni") nga nëpunësi i këtij institucioni/ kërkuesi shkencor/ tjetër, i cili që ka akses në përdorimin e të dhënave që disponon institucioni për qëllime statistikore.

Qëllimi

Kjo deklaratë nënshkruhet nga të gjithë individët të cilët kanë akses në të dhënat e INSTAT-it. Deklarata përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë akses në informacione të tilla dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

Fusha e veprimit

Fushë veprimi i kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat dhe informacionet konfidenciale që njihen gjatë punës në institucion. Dispozitat përkatëse zbatohen, pavarësisht faktit nëse Deklaruesi vazhdon të jetë në marrëdhënie pune ose jo me institucionin të cilit i drejtohet kjo deklaratë

Deklarata e konfidencialitetit

Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdorë dhe të mos u transmetojë personave të paautorizuar të dhëna apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga institucioni, përveç rastit kur autorizohem shprehimisht nga Titullari i Institucionit ose kur kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen si gjatë afatit të mbledhjes të të dhënave, ashtu dhe pas përfundimit të tij.

Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave, trajtohet nga Ligji nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare" dhe Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.

Unë e kuptoj se jam i detyruar të ruaj konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t'i mbaj ato të sigura, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.

Unë deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se do të mbaj çdo informacion apo të dhënë personale për të cilat jam vënë në dijeni gjatë ushtrimit të funksionit pranë institucionit, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës me institucionin.

Unë marr përsipër përgjegjësinë e plotë që në qoftë se, konstatohet se kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të ruajtur imazhin e institucionit dhe respektuar të drejtat themelore të individëve, për sa i takon parimit të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale.

Emri, atësia, mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Pozicioni: _____

Drejtorja/Spektori: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Shtojca 2: Deklaratë konfidencialiteti për kërkuesit shkencor

Unë i/e nënshkruari/a, në cilësinë e _____ nëpërmjet këtij dokumenti deklaroj se pranoj të marr përsipër të mos përdor dhe të mos u transmetoj personave të paautorizuar të dhëna apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga INSTAT, në kuadër të projektit të kërkimit, titulli i projektit _____, emërtimi i skedarit të kërkuar, _____, përveç rastit kur autorizohem shprehimisht nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it.

1. Duke nënshkruar këtë deklaratë, deklaroj se jam në dijeni se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave trajtohet nga Ligji nr. 17, datë 5.4.2018 "Për statistikën zyrtare", Ligji nr. 9987, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë që marr dijeni gjatë punës time për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.

2. Unë deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se jam i detyruar të ruaj konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t'i mbaj ato të sigurt, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen si gjatë afatit të projektit të kërkimit, ashtu dhe pas përfundimit të tij.

3. Unë marr përsipër përgjegjësinë e plotë që në qoftë se, konstatohet se kam vepruar në kundërshtim me udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të ruajtur imazhin e institucionit dhe respektuar të drejtat themelore të individëve, për sa i takon parimit të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale.

4. Unë e kuptoj se kam detyrim të zhduk menjëherë çdo informacion apo të dhënë personale për të cilat jam vënë në dijeni sapo projekti përfundon, duke njoftuar me shkrim INSTAT-in për këtë veprim. 5. Unë e kuptoj se moszbatimi ose shkelja e kërkesave të konfidencialitetit, të përcaktuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 17, datë 5.4.2018 për "Statistikën Zyrtare", përbën kundërvajtje administrative sipas përcaktimit të nenit 38, shkronja b) dhe dënohet me gjobë nga 20 000 lekë deri në 30 000 lekë.

Për: _____

Emër Mbiemër: _____

Nënshkrimi: _____

Pozicioni: _____